



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**  
**V E N D I M**  
**K.P.P. 202/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*OL - Vahrom*” SHPK dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “*Gentian Horieti*” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 67976-08-06-2020, me objekt “*Blerje materiale bojaxhiu*”, me fond limit 66.666.580 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “*Deutschcolor*” SHA.

Lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “*Vila Dekor*” SHPK, dhe “*IDK Konstruksion*” SHPK.

**Ankimues:**

“*Ol - Vahrom*” SHPK.  
Adresa: Rruga “*Dibrës*”, Nr. 403, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.  
Adresa: Rruga “*5 Maj*”, God. 17, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të*

*prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.08.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 67976-08-06-2020, me objekt “*Blerje materiale bojaxhiu*”, me fond limit 66.666.580 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

II.2. Në datën 21.09.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se në datën 19.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton si më poshtë vijon:

1. “I.D.K Konstruksion” SHPK	42.993.560 lekë	skualifikuar
2. “Vila Dekor” SHPK	48,024.560 lekë	skualifikuar
3. “Deutschcolor” SHA	53.619.016 lekë	skualifikuar
4. “OL-Vahrom” SHPK	56.951.060 lekë	skualifikuar
5. “Gentian Horieti” PF	58.757.696 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.10.2020 operatori ekonomik “OL-Vahrom” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*1 1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr.,aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007. Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015. Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.*

*2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)” [produkti nr. 17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Adesiflex” me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dyshemeje, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundra lagështirës. Për më tepër raport testi për produktin “Adesiflex” i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr. aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standardeve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standardeve rezulton që këto standarde janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës*

(hidroizolues), ku standardi që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për EN14891:2017, për produkte të papërshkueshëm nga uji. Asnjë nga standardet që përmbush produkti i ofruar nuk është ekuivalent me standardin e e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10 dhe kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Zmalto” [produkti nr.7 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Metal Care” me prodhues Er-Lac, ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën Nr.10.

4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastër. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom SHPK me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1.Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laprakë), Tiranë, 2.Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3.Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Furçë për lyerje me gëlqere profesionale” [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wall Brushes and White Wash Brushes”, me prodhues Token Tooling. Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

II.4.1. Në datën 26.10.2020, operatori ekonomik ankimues “OL-Vahrom” SHPK ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Gentian Horietit”, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Deutschcolor” SHA, dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “Vila Dekor” SHPK, dhe “IDK Konstruksion” SHPK. në procedurën e mësipërme e prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

*Ne date 21.09.2020 kemi dorezuar oferte ne tenderin me numer REF-67976-08-06-2020, te organizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane me objekt: "Blerje materiale bojaxhiu", me vlere 66.666.580 leke, i cili u zhvillua ne date 21.09.2020.*

*Po me date 21.09.2020, ora 08:30, morem pjese ne dorezimin e mostrave, te kerkuara per te gjithë artikujt objekt prokurimi, proces i cili ishte shume transparent, pasi pame dhe mallrat e dorezuara nga ofertuesit e tjere pjesemarres, proces te cilin e kemi te filmuar nga ana e perfaqsesit tone dhe qe po jua veme ne dispozicion me DVD-ne bashkëlidhur kesaj ankese.*

*Ne date 06.10.2019, ora 11:48, ne Sistemin Elektronik te Prokurimit, ne rubriken "Kerkesa nga AK" jeni njoftuar nga enti prokurues lidhur me "Pezullimin e Procedures", duke na derguar mesazhin e meposhtem:*

*Nioftim*

*Ne zbatim te Ligiit Nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. V.KM Nr. 914. date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar, iu bejme me dije se Komisioni i Hapjes dhe Vleresimit te Ofertave gjykon se i nevojitet me shume kohe per te perfunduar veprimtarine e tij per tenderin me objekt: Blerje materiale bojaxhiu. Numri i references se procedures REF-67976-08-06-2020 dhe fond limit: 66.666.580 (gjashtedhjetë e gjashtë milion gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e peseqind e tetëdhjetë) leke pa TVSH. Kjo kerkesë behet per shkak te numrit te operatoreve ekonomik pjesemarres dhe verifikimit te dokumentacionit te paraqitur per kete procedure prokurimi. Ne zbatim te nenit 66 V.K.M Nr. 914. date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar ku nder te tjera citohet: Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave.*

*1. Pas hapjes dhe leximit te ofertes sic percaktohet me lart komisioni i vleresimit te ofertave nese gjykon se i nevojitet me shume se nje dite pune per te perfunduar veprimtarine e tij ve ne dijeni perfaqsesit per oren dhe daten kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati vleresimit te ofertes qe perfshin ate teknike nese ka te tille ekonomike si dhe klasifikimin perfundimtar.*

*2. Kohezgjatja e procedures se vleresimit nuk duhet te kaloje 15 (pesembedhjetë) dite pervec rasteve te tjera te cilesuara ndryshe ne keto rregulla. Ne rast se komisionit te vleresimit te ofertave i lind nevoja per verifikime ose ndryshime te nje apo me shume anetareve afati i vleresimit pezullohet ne momentin e paraqitjes se kerkeses per verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku eshte pezulluar me marrjen e pergjigjes apo zyrtarizimit te anetarit/anetareve.*

*Per sa me sipër po iu vendosim ne dijeni ne lidhje me ecurine e kesaj procedure prokurimi.*

*Pra ky pezullim i procedurës më datë 06.10.2020, është bërë në shkelje të rëndë të nenit 66, pika 2 të VKM NR.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi është bërë në ditën e 16 (gjashtëmbëdhjetë), pasi datë e hapjes së ofertave ishte data 21.09.2020, ndërkohë që ky nen përcakton që afati i vlerësimit të ofertave është 15 ditë dhe se afati i vlerësimit*

mund të përzullohej vetëm brenda këtyre 15 ditëve dhe jo në ditën e 16 sikurse ka vepruar enti prokurues.

Gjithashtu edhe për justifikimin e dhënë nga enti prokurues dhe konkretisht 2 (dy) arsyet e pezullimit të afateve të vlerësimit të cilat janë si më poshtë:

1- “Kjo kërkesë bëhet për shkak të numrit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës”, një justifikim i entit prokurues (dhe konkretisht i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) i papërligjur dhe jobindës, pasi sipas njoftimit të skualifikimit konstatohet se numri i pjesëmarrësve në tender është 5 (pesë) ofertues, një numër mëse normal pjesëmarrësish.

2- “verifikimit të dokumentacionit të paraqitur për këtë procedurë prokurimi” pretendim i entit prokurues (dhe konkretisht i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) është i kundraligjshëm dhe me qëllime të mbrapshta jo vetëm për favorizimin e kompanisë së vetme të kualifikuar (duke verifikuar përciptasi dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë me qëllimin e vetëm skualifikimin tonë), por edhe se nuk është ruajtur barazia në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve, fakt të cilin do ta shtjellojmë më poshtë në ankesën tonë.

Në datë 19.10.2020, ora 12:47, enti prokurues na ka njoftuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, renditjen nga ku ofertuesit që kishin marrë pjesë ishin si më poshtë:

<i>Operator ekonomik</i>	<i>Vlera te ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>IDK KONSTRUKSION</i>	<i>42.995.560</i>	<i>PO</i>
<i>VILA DEKOR</i>	<i>48.024.560</i>	<i>PO</i>
<i>DEUTSCHCOLOR</i>	<i>53.619.180</i>	<i>PO</i>
<i>OLVAHROM</i>	<i>56.951.060</i>	<i>PO</i>
<i>GENTIAN HORIETI</i>	<i>58.757.960</i>	<i>JO</i>

Në datë 19.10.2020, ora 12:47, enti prokurues na ka dërguar në Sistemin Elektronik të Prokurimit Njoftimin e Skualifikimit nga ku oferta e jonë është skualifikuar me pretendimet si më poshtë:

#### **REASONS,**

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshtëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr.aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007. Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015. Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim

*i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kritereve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.*

*2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)” [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Adesiflex” me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dysHEMEJE, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundra lagështirës. Për më tepër raport testi për produktin “Adesiflex” i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr.aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standareve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standardeve rezulton që këto standarde janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës (hidroizolues), ku standardi që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për EN14891:2017, për produkte të papërshkueshëm nga uji. Asnjë nga standardet që përmbush produkti i ofruar nuk është ekuivalent me standardin e e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10 dhe kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kritereve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.*

*3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Zmalto” [produkti nr.7 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Metal Care” me prodhues Er-Lac, ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën Nr.10.*

*4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastrë. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom SHPK me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1.Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laprakë), Tiranë, 2.Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3.Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe*

përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Furçë për lyerje me gëlqere profesionale” [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wall Brushes and White Wash Brushes”, me prodhues Token Tooling. Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

Kompania jonë duke mos qenë dakort me arsyet e akualifikimit, në bazë të parashikimeve të nenit 63, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, po paraqet kundërshtimet e saj lidhur me arsyet e skualifikimit të ofertës sonë, por edhe kundërshtimin e kualifikimit të ofertuesit të vetëm të kualifikuar si më poshtë:

- Kundërshtojmë arsyet e skualifikimit me rradhë si më poshtë:

Arsyeja e parë e skualifikimit:

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007. Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015. Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

Ne si ofertues vërejmë se arsyeja e skualifikimit është mosplotësimi i pikës 1, të “Kriterëve të Përgjithshme të Pranim/kualifikimit” në Shtojcën nr.9, si dhe i pikës 2.3.f të “Kapacitetit teknik” të “Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit” në Shtojcën nr. 9 të dokumenteve të tenderit.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarojmë:



*1/a. Në Shtojcën 9, “Kritereve të Përgjithshme të Pranim/kualifikimit”, Pika 1 nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:*

*Shtojca 9*

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

*a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

*b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

*c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

*ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

*Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.*

*Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

*Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:*

*a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*

*b. Prokura e posaçme.*

*Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim në këmi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “Shtojcat e bashkuara OL-VAHRUM” ku në faqen 17 është e plotësuar, vulosur dhe firmosur Shtojca 8 e dokumenteve të tenderit “Deklaratë mbi plotësimin e kritereve të përgjithshme”, sikurse parashikon kriteri kualifikues i përmendur më sipër, duke e plotësuar kriterin kualifikues të dhënë në Shtojcën 9 “Kritereve të Përgjithshme të Pranim/kualifikimit”, Pika 1, prandaj arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.*

*1/b. Në Shtojcën 9, “Kritereve të veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.f të dokumenteve të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:*

- f) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen standarde kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën Nr.10 Specifikimet Teknike, duhet të paraqesë raportet e testimit, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara.*

*Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim ne kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “Skeda teknike raport testimi PREMIX” ku në këtë dokument është i pasqyruar si skeda teknike ashtu dhe raporti i testimit të cilat kërkohen për të përmbushur kriterin kualifikues sipas autoritetit kontraktor, duke e plotësuar kërkesën për kualifikim.*

*Gjithashtu referuar skedës teknike në të cilën thuhet se ky produkt përmbush standardin EN 998-1, fakt të cilin e vërteton më së miri dhe raporti i testimit i dorëzuar nga ana jonë ku thuhet se ky produkt është i testuar sipas metodave të testimit si në vijim: EN 1745:2012, EN 1015-18, EN1015-12 dhe EN 1015-19, të cilat janë metoda testimi që përcaktojnë standardin en 998-1, (fakt ky i cili pasqyrohet në broshurën e standardit en 998-1:2016, të cilën ne e kemi blerë pranë drejtorisë së përgjithshme të standardeve dhe të cilën po jua vëmë në dispozicion bashkëlidhur kësaj ankese) dhe që në të njëjtën kohë meqënëse ju pezulluar procedurën më datë 06.10.2020 (pezullim i cili megjithëse në shkelje të rëndë të ligjit, ju nuk e shfrytëzuar për të bërë verifikimet e nevojshme, por thjesht e keni përdorur si justifikim për të përligjur vlerësimin e procedurës në tejkalim të afateve ligjore) ju kërkojmë që të bëni verifikimet përkatëse jo vetëm pranë drejtorisë së përgjithshme të standardeve, por edhe pranë zyrës noteriale që ka vërtetuar dokumentin, nëse dokumenti i përkthyer ekziston apo jo përpara se të na ktheni përgjigje, pasi mosmarrja parasysh e kësaj kërkesë do të na detyrojë jo vetëm ti drejtohem KPP, por edhe krimin ekonomik e prokurorisë.*

*Gjithashtu i kërkojmë dhe sfidojmë entin prokurues që në zbatim të kërkesave të parashikuara në Nenin 13 të LPP-së, neneve 27 dhe 83 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e reegullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe Pikës 2, të Udhëzimit nr. 2 , datë 02.05.2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë sonë, në prani të specialistëve të entit prokurues, si dhe në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë fituese të bëjë provat reale me këtë produkt, duke bërë provën në realitet me një mostër (p.sh realizimi i një punimi të parashikuar në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit për produktin me numër rendor nr.16) dhe të shohim rezultatën konkret nëse sipas skedës teknike ky produkt është llaç apo jo, pasi një nga qëllimet për të cilat kërkohet mostra është dhe plotësimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.h të “Kritereve të veçanta për kualifikim” të Shtojcës 9 ku është përcaktuar nga ana juaj se: “Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”, pra përputhja e mostrës me specifikimet teknike dhe konkretisht me specifikimin teknik të dhënë në shtojcën 10, për artikullin me numër rendor nr.16 ku është përcaktuar: “Llaçi i gatshëm të jetë i prodhuar për aplikim si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, dhe të jetë i përgatitur në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv.”, bëhet*

jo vetëm nëpërmjet dokumentacionit (pasi dokumentacioni mund të jetë i rremë), jo vetëm me kqyrjen e jashtme të mostrës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me llojin e paketimit, sasinë e produktit, konfeksionin, por edhe nëpërmjet realizimit të provave reale me produktin për të parë nëse vetitë fizike dhe mekanike që ka ky produkt realizojnë apo jo qëllimin e blerjes së tij nga ana e entit prokurues lidhur me (plotësimin e specifikimeve teknike) faktin nëse aplikohet si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, nëse aplikohet në ambiente të jashtme ose të brendshme, si dhe për të parë nëse është në formë pluhuri me bazë cemento. Në rast se nga kryerja e provës reale konstatohet se produkti "premix" nuk është llaç jemi të gatshëm të mbajmë përgjegjësi ligjore jo vetëm duke na skualifikuar dhe përjashtuar nga tenderat por edhe përgjegjësi penale për mashtrim, por kurrësi nuk mund të pranojmë skualifikimin e oferteës sonë për produktin "llaç i gatshëm", pasi jo vetëm ne por edhe ju anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave në ndërgjegjen tuaj jeni mëse të bindur se produkti i ofruar nga ne "premix" është llaç i gatshëm.

Në vazhdim nuk duam ta besojmë se qëllimi juaj është skualifikimi me patjetër i ofertës sonë më të leverdisshme ekonomike (pasi ju më datë 06.10.2020 na njoftuat se kërkonit kohë më shumë për verifikim, kur ndërkohë jo vetëm nuk bëtë verifikime por na skualifikuat apriori ndonëse mostrat i keni në administrim dhe mund të bënit provat faktike me produktin për të parë nëse plotësonit specifikimet teknike dhe qëllimin tuaj), pasi në këtë rast nuk ka emër tjetër veçse trajtim jo i barabartë i pjesmarrësve në tender, favorizim i ofertuesit të vetëm të kualifikuar dhe shpërdorim detyrë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Si përfundim arsyeja e parë e skualifikimit nuk qëndron, pasi është dorëzuar Shtojca 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit", skeda teknike dhe produkti "PREMIX", i cili plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por dhe qëllimin e blerjes së këtij produkti nga ana e entit prokurues, si dhe raporti i testimit i cili vërteton se produkti i ofruar është testuar sipas standardeve që parashikon standardi i kërkuar në shtojcën 10 për artikullin me numër rendor nr. 16 "LLAÇ I GATSHËM".

Arsyeja e dytë e skualifikimit:

2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për "Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)" [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin "Adesiflex" me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dysHEMEJE, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundër lagështirës. Për më tepër raport testi për produktin "Adesiflex" i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr.aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standardeve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standardeve rezulton që këto standarde janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës (hidroizolues), ku standardi që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për

EN14891:2017, për produkte të papërshkueshme nga uji. Asnjë nga standardet që përmbush produkti i ofruar nuk është ekuivalent me standardin e e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10 dhe kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9. Ne si ofertues vërejmë se arsyeja e skualifikimit është mosplotësimi i pikës 2.3.f të “Kapacitetit teknik” të “Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit” në Shtojcën nr. 9, për produktin me numër 17 në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarohet:

1. Në Shtojcën 9, “Kriterëve të veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.f të dokumenteve të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:

f) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen standarde kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën Nr.10 Specifikimet Teknike, duhet të paraqesë raportet e testimit, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara.

Në Shtojcën 10 “Specifikimet teknike” për produktin me numër rendor janë dhënë specifikimet teknike si në vijim:

#### 17. KOLLE SPECIALE ANTI LAGËSHIRË (hidroizolues)

Material dykomponentesh me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarracë, themele, bodrume, tualete etj. Duke përzier te dy komponentet përfitohet një mase që aplikohet në sipërfaqet të cilat duhet të hidroizolohen. Aplikimi i materialit bëhet me furçë ose mallë me disa duar.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Komponenti A (pluhur) + Komponenti B (lëng).

- Konsumi teorik: 1-4 kg/m<sup>2</sup>

- Djegshmëria: i padjegshëm

- Temperatura e punueshmërisë: në intervalin + 50C - + 300 C

- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 50C - + 300 C në ambient të thatë

- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 vit

- Paketimi: Komponenti A në thasë 20 - 30 kg + Komponenti B në bidon 5 – 10 kg

STANDARDET që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standardin Shqiptar SSH EN 14891:2017 ose ekuivalentin e tij, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji.

Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim në kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “Skede teknike raport testimi ADESIFLEX (Kollë kundër lagështirës” ku në këtë dokument është i pasqyruar si skeda teknike në të cilën janë dhënë parametrat teknike të këtij produkti, të cilat plotësojnë specifikimet teknike të dhëna në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit,

*pasi bëhet fjalë për një produkt dykomponentësh, i cili ka veti ngjitëse (pra është kollë) dhe veti hidroizoluese (pra që nuk e përshkruan uji).*

*Gjithashtu referuar raportit të testimit të pasqyruar në dokumentin e sipërpërmendur është përshkruar se produkti ADESIFLEX është testuar sipas metodave të testimit: en 1346:2008; en 1348:2008; en 1308:2009 dhe en 12002:2009, metoda testimi të cilat përfshihen në standardin en 12004:2:2016 (fakt ky i cili pasqyrohet në brodhurën e standardit en 12004:2:2016, të cilën mund ta verifikoni pranë drejtorisë së përgjithshme të standardeve), ndërkohë që standardi en 12004:2:2016 është ekuivalent i standardit en 14891:2017, përsa i përket vetive lidhur me mospërshkueshmërinë e ujit, të cilin mund ta verifikoni fare lehtë në broshurën e standardit ssh en iso 14891:2017 (të cilin ne e kemi blerë dhe po jua vëmë në dispozicion), dhe që në të njëjtën kohë meqënëse ju pezulluat procedurën më datë 06.10.2020 (pezullim i cili megjithese në shkelje të rëndë të ligjit, ju nuk e shfrytëzuar për të bërë verifikimet e nevojshme, por thjesht e keni përdorur si justifikim për të përlegjur vlerësimin e ofertës në tejkalim të afateve ligjore) ju kërkojmë që të bëni verifikimet përkatëse pranë drejtorisë së përgjithshme të standardeve përpara se të na ktheni përgjigje, pasi mosmarrja parasysht e kësaj kërkesë do të na detyrojë jo vetëm ti drejtohem KPP, por edhe krimin ekonomik e prokurorisë.*

*Ndërkohë lidhur me verifikimin që ka bërë autoriteti kontraktor në faqen e internetit të kompanisë prodhuese DEKOLL, i bëjmë me dije që të kontrollojë mirë faqen e web-it të kësaj kompanie dhe të mos skualifikojë ofertën duke u shprehur: “Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundër lagështirës.”, pasi për ta kulturuar Komisionin e Vlerësimit të Ofertave po i vëmë në dispozicion linkun dhe ta verifikojë lehtësisht produktin e ofertuar nga ana jonë dhe konkretisht linku: <https://www.dekoll.al/dekoll/product/adesiflex-ab/> (të cilën po jua japim me foto më poshtë)*

**deKoll**  
PREMIUM PER L'EDILIZIA

RRETH NESH    SISTEME    PRODUKTE    ZBULONI    BLOG    KONTAKT    KOMPANITE

## ADESIFLEX A+B

CERTIFIKATA E GARANCISE

Karakteristikat :

- Punueshmeri shume e mire
- Fleksibilitet
- Force ngjitese e larte
- I pershtatshem per ambiente me lageshti
- Nuk rreshket ne suportte vertikale

Perberesit :

- Cimento e bardhe CEM I 52,5 R
- Rere mermeri shume cilesore me granulometri te seleksionuar
- Rezina sintetike dhe aditive special te modifikuar

Percaktimi i vetive fiziko-mekanike te produktit ADESIFLEX A+B EN 12004

PERSHKRIMI REZULTATET STANDARTI EN 12004

Gjithashtu i kërkojmë dhe sfidojmë entin prokurues që në zbatim të kërkesave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë sonë, në prani të specialistëve të entit prokurues, si dhe në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë fituese të bëjë provat reale me këtë produkt, duke bërë provën në realitet me një mostër (p.sh realizimi i një punimi të parashikuar në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit për produktin me numër rendor nr.17) dhe të shohim rezultatin konkret nëse sipas skedës teknike ky produkt është KOLLË KUNDËR LAGËSHITIRËS apo jo, pasi një nga qëllimet për të cilat kërkohet mostra është dhe plotësimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.h të “Kritereve të veçanta për kualifikim” të Shtojcës 9 ku është përcaktuar nga ana juaj se: “Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”, pra përputhja e mostrës me specifikimet teknike dhe konkretisht me specifikimin teknike të dhënë në shtojcën 10, për artikullin me numër rendor nr.17 ku është përcaktuar: “Material dykomponentesh me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarracë, themele, bodrume, tualete etj. Duke përzier të dy komponentet përfitohet një masë që aplikohet në sipërfaqet të cilat duhet të hidroizolohen. Aplikimi i materialit bëhet me furçë ose mallë me disa duar.”, bëhet jo vetëm nëpërmjet dokumentacionit (pasi dokumentacioni mund të jetë i rremë), jo vetëm me kqyrjen e jashtme të mostrës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me llojin e produktit (nëse është dykomponentësh), llojin e paketimit, sasinë e produktit, konfeksionin, por edhe nëpërmjet realizimit të provave reale me produktin për të parë nëse vetitë fizike dhe mekanike që ka ky produkt realizojnë apo jo qëllimin e blerjes së tij nga ana e entit prokurues lidhur me (plotësimin e specifikimeve teknike) faktin nëse aplikohet si material dykomponentësh me bazë çimentoje dhe hidroizolues, nëse duke përzier të dy komponentët përfitohet një masë që aplikohet në sipërfaqe të cilat duhet të hidroizolohen, nëse mund të aplikohet me furçë apo mall. Në rast se nga kryerja e provës reale konstatohet se produkti ”ADESIFLEX” nuk është kollë speciale antilagështirë

jemi të gatshëm të mbajmë përgjegjësi ligjore jo vetëm duke na skualifikuar dhe përjashtuar nga tenderat, por edhe përgjegjësi penale për mashtrim, por kurrësesi nuk mund të pranojmë skualifikimin e ofertës sonë për produktin "Kollë speciale antilagështirë", pasi jo vetëm ne por edhe ju anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në ndërgjegjen tuaj jeni mëse të bindur se produkti i ofruar nga ne "ADESIFLEX" është KOLLË SPECIALE ANTILAGËSHTIRË.

Në vazhdim nuk duam ta besojmë se qëllimi juaj është skualifikimi me patjetër i ofertës sonë më të leverdisshme ekonomike (pasi ju më datë 06.10.2020 na njoftuat se kërkonit kohë më shumë për verifikim, kur ndërkohë jo vetëm nuk bëtë verifikime por na skualifikuat apriori ndonëse mostrat i keni në administrim dhe mund të bënit provat faktike me produktin për të parë nëse plotësonit specifikimet teknike dhe qëllimin tuaj), pasi në këtë rast nuk ka emër tjetër veçse trajtim jo i barabartë i pjesëmarrësve në tender, favorizim i ofertuesit të vetëm të kualifikuar dhe shpërdorim detyre nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Gjithashtu ju bëjmë më dije se sipas përcaktimit të bërë në shtojcën 10, ju keni kërkuar të blini kollë speciale antilagështirës (pra një produkt që të ketë dhe veti ngjitëse dhe veti hidroizoluese), e cila të plotësojë Standardin EN 14891:2017 (standard të cilin ne e kemi ankimuar edhe më parë dhe në entin prokurues dhe në KPP, por që KPP vendosi që autoriteti kontraktor është në të drejtën e vet për të kërkuar standarde të caktuara) dhe për të parë se çfarë përmban ky standard vajtëm dhe blemë broshurën e standardit (të cilin po jua vëmë në dispozicion) dhe ku thuhet shprehimisht: Produkte të lëngëshme të papërshkueshme nga uji për përdorim nën tjegulla qeramike të ngjitura me lëndë ngjitëse. Kërkesat, metodat e provës, vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës klasifikimi dhe shënjimi, ky standard nuk është për kollë, por për produkt hidroizolues dhe pas përdorimit të këtij produkti përdoret kolla, pra standardi i vendosur nga ana juaj nuk është për produktin kollë, fakt të cilin mund ta verifikoni në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit.

Ndërkohë lidhur me kërkesën tonë që të bëhen provat faktike për produktin "ADESIFLEX" kërkojmë dhe ftojme entin prokurues që të bëjë provën faktike dhe me produktin e ofertuesit të vetëm të kualifikuar nga ana juaj.

Gjithashtu sikurse ju përmendëm dhe në krye të ankesës më datë 21.09.2020, në momentin e dorëzimit të ofertave (fazë e cila për hir të së vërtetës është i vetmi moment i pastër dhe jokorruptiv i entit prokurues) i cili u bë në prani të të gjithë shoqërive pjesëmarrëse, fazë e cila është e filmuar nga ana jonë konstatoam, se ofertuesi i vetëm i kualifikuar nga ana juaj "Gentian Horieti" p.f për produktin me numër rendor.17 në Shtojcën 10 "kollë speciale anti lagështirë (hidroizolues)" ka dorëzuar mostrën e produktit "WEBERTEC AQUASTOP 2K", i cili gjendet lehtësisht në treg dhe të cilin ne si kompani e kemi blerë tek kompania "Saint-Gobain Construction Product Albania" të shoqëruar me skedën teknike dhe raportin e testimit dhe po ju konfirmojmë që ky produkt (sipas skedës teknike) është material hidroizolues, por jo kollë (ngjitës), ndërsa sipas raportit të testimeve nr. PTD-19.40/11.11.2019 dhe nr.PTD-19.39/11.11.2019 nuk e plotëson standardin EN 14891:2017, por standardin EN 14891:2012, i cili është i shfuqizuar (për më tepër mund ti referoheni faqes se WEB-it të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al) dhe konkretisht në Rubrikën: Katalogu i standardeve). Ndërkohë referuar përcaktimeve të nenit 1, pika 2/d të Ligjit nr.9643, datë

20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “2. Qëllimi i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”, do të jetë më mirë për autoritetin kontraktor ta verifikojë një fakt të tillë duke ju vënë në dispozicion dokumentacionin i cili na u vu në dispozicion nga firma “Saint-Gobain Construction Product Albania”. Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përdorur dy standarde për vlerësimin e ofertave, pasi ka kualifikuar një ofertë e cila nuk plotëson kërkesën për kualifikim të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.f të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër arsyeja e dytë e skualifikimit nuk qëndron, pasi kemi paraqitur skedën teknike dhe produktin “ADESIFLEX”, i cili plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por dhe qëllimin e blerjes së këtij produkti nga ana e entit prokurues, si dhe raportin e testimit ku vërtetohet se produkti i ofruar është testuar sipas metodave të testimit për përmbushjen e standardit EN 14002:2-2016 lidhur me vetitë e mospërshkrimit të ujit, i cili është ekuivalent me standardin EN 14891:2017 lidhur me vetitë e mospërshkrimit të avujve të ujit, ndërkohë që Standardi EN 14891:2017 sipas BROSHURES SE KETIJ STANDARDI të blerë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit nuk është standard që përdoret për KOLLË, por për materiale hidroizolimi çatie me tjegulla. Si dhe produkti i ofruar i plotëson kërkesat e entit prokurues pasi është edhe KOLLË edhe HIDRIZOLUES njëkohësisht.

Arsyeja e tretë e skualifikimit:

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Zmalto” [produkti nr.7 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Metal Care” me prodhues Er-Lac, ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën Nr.10.

Ne si ofertues vërejmë se arsyeja e skualifikimit është mosplotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën 10.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarohet:

1. Në Shtojcën 9, “Kritereve të veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.e të dokumenteve të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:

e) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli të kërkuara në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.



Në Shtojcën 10 “Specifikimet teknike” për produktin me numër rendor janë dhënë specifikimet teknike si në vijim:

## 7. BOJË ZMALTO

Boja të jetë smalto me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike, druri dhe suvaje.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- |                           |  |
|---------------------------|--|
| - Natyra e lidhësit:      | Rezinë Alkide  |
| - Tretësi:                | Përzierje hidrokarburesh olifatike                                       |
| - Tharja:                 | 4-10 orë   |
| - Norma e hapjes:         | $\geq 10 \text{ m}^2 / \text{litër}$ (me një shtresë)                    |
| - Hollimi:                | 5-20% me tretës  |
| - Peshë specifike:        | $1.2 \pm 0.1 \text{ kg/litër}$   |
| - Pamja estetike:         | me shkëlqim  |
| - Ngjyrat në dispozicion: | E bardhë ose të ndryshme sipas katalogut                                 |
| - Magazinimi:             | Në temperatura në intervalin $+ 5^{\circ}\text{C} - +30^{\circ}\text{C}$ |
| - Paketimi:               | Në konfeksion 0.5-5 Litër  |

STANDARDET SHQIPTARE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë Klasa e I-rë.
- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë Klasa e I-rë.

Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim ne kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “Skedë teknike raport testimi METAL CARE (Bojë zmalto)” ku në këtë dokument është i pasqyruar si skeda teknike në të cilën janë dhënë parametrat teknike të këtij produkti, të cilat plotësojnë specifikimet teknike të dhëna në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit, ndërkohë që raporti i testimit i plotëson standardet e kërkuara, pra nuk qëndron pretendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike. Ndërkohë lidhur me konstatimin e çalë dhe dashakeqës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “... ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj”, ju bëjmë me dije se:

Së pari: Në faqen 8 të dokumentit të sipërpërmendur citohet: **SIPËRFAQJA**

Sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme prej druri dhe metalike, pra pretendimi juaj se ky produkt nuk është i përdorshëm për sipërfaqe druri nuk qëndron, pasi referuar skedës teknike ky produkt u përdorka dhe për sipërfaqe druri.

Së dyti: Referuar skedës teknike dhe raportit të testimit, ky produkt plotëson të gjitha specifikimet teknike të dhëna nga ana juaj si: Natyra e lidhjes, Hollimi, Norma e hapjes, Tharja, Peshë specifike, standardet SSH EN ISO 6504-3:2007 dhe SSH EN ISO 11998:2006 (Specifikime teknike dhe standarde të cilat ne besojmë që enti prokurues i ka hartuar për produkt që përdoret në sipërfaqe

metalik, sipërfaqe druri, mbi suva etj) dhe plotësimi i të gjithë këtyre parametrave vërteton më së miri që ky produkt i ofruar nga ana jonë përdoret edhe mbi suva, duke plotësuar kërkesat e entit prokurues.

Gjithashtu i kërkojmë dhe sfidojmë entin prokurues që në zbatim të kërkesave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë sonë, në prani të specialistëve të entit prokurues, si dhe në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë fituese të bëjë provat reale me këtë produkt, duke bërë provën në realitet me një mostër (p.sh realizimi i një punimi të parashikuar në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit për produktin me numër rendor nr.7) dhe të shohim rezultatin konkret nëse sipas skedës teknike ky produkt është llaç apo jo, pasi një nga qëllimet për të cilat kërkohet mostra është dhe plotësimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.h të “Kritereve të veçanta për kualifikim” të Shtojcës 9 ku është përcaktuar nga ana juaj se: “Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”, pra përputhja e mostrës me specifikimet teknike dhe konkretisht me specifikimin teknik të dhënë në shtojcën 10, për artikullin me numër rendor nr.7 ku është përcaktuar: “ Boja të jetë smalto me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agentëve atmosferikë. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe metalike, druri dhe suvaje”, bëhet jo vetëm nëpërmjet dokumentacionit (pasi dokumentacioni mund të jetë i rremë), jo vetëm me kqyrjen e jashtme të mostrës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me llojin e paketimit, sasinë e produktit, konfeksionin, por edhe nëpërmjet realizimit të provave reale me produktin për të parë nëse vetitë fizike dhe mekanike që ka ky produkt realizojnë apo jo qëllimin e blerjes së tij nga ana e entit prokurues lidhur me (plotësimin e specifikimeve teknike) faktin nëse aplikohet mbi sipërfaqes druri, metalike dhe suvaje. Në rast se nga kryerja e provës reale konstatohet se produkti “METAL CARE” (e cila prodhohet nga kompania prestigjioze greke ER-LA S.A) nuk është bojë zmalto për përdorim mbi sipërfaqe druri dhe mbi suva, jemi të gatshëm të mbajmë përgjegjësi ligjore jo vetëm duke na skualifikuar dhe përjashtuar nga tenderat, por edhe përgjegjësi penale për mashtrim, por kurrësesi nuk mund të pranojmë skualifikimin e ofertës sonë për produktin “Bojë zmalto”, pasi jo vetëm ne por edhe ju anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në ndërgjegjen tuaj jeni mëse të bindur se produkti i ofruar nga ne “METAL CARE” është BOJË ZMALTO.

Në vazhdim nuk duam ta besojmë se qëllimi juaj është skualifikimi me patjetër i ofertës sonë më të leverdishme ekonomike (pasi ju më datë 06.10.2020 na njoftuat se kërkonit kohë më shumë për verifikim, kur ndërkohë jo vetëm nuk bëtë verifikime por na skualifikuat apriori ndonëse mostrat i keni në administrim dhe mund të bënit provat faktike me produktin për të parë nëse plotësonte specifikimet teknike dhe qëllimin tuaj), pasi në këtë rast nuk ka emër tjetër veçse trajtim jo i barabartë i pjesëmarrësve në tender, favorizim i ofertuesit të vetëm të kualifikuar dhe shpërdorim detyre nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Ndërkohë lidhur me kërkesën tonë që të bëhen provat faktike për përdorimin mbi sipërfaqe druri dhe mbi suva të produktit të ofruar nga ana jonë, kërkojmë dhe ftojme entin prokurues që të bëjë provën faktike dhe me produktin e ofertuesit të vetëm të skualifikuar nga ana juaj.

Gjithashtu sikurse ju përmendëm dhe në krye të ankesës më datë 21.09.2020, në momentin e dorëzimit të ofertave (fazë e cila për hir të së vërtetës është i vetmi moment i pastër dhe jokorruptiv i entit prokurues) i cili u bë në prani të të gjithë shoqërive pjesëmarrëse, fazë e cila është e filmuar nga ana jonë konstatuam se ofertuesi i vetëm i kualifikuar nga ana juaj “Gentian Horieti” p.f për produktin me numër rendor.7 në Shtojcën 10 “BOJË ZMALTO” ka dorëzuar mostrën e produktit “Holz und Metal 270”, produkt i cili prodhohet nga kompania DEUTHCOLOR SHA, dhe ku sipas skedes teknike në gjuhën angleze (të cilën po jua vëmë në dispozicion të përkthyer dhe noterizuar) në faqen zyrtare të kësaj kompanie (pasi në gjuhën shqipe skeda teknike nuk është e disponueshme) dhe konkretisht në linkun: <https://deutschcolor.com/en/product/holz-und-metal-270/>, konstatohet se ky produkt rekomandohet nga prodhuesi për tu përdorur vetëm për sipërfaqe metalike, pasi në skedën teknike nuk përmendet fare që mund të përdoret në sipërfaqe druri dhe mbi suva.

Ndërkohë referuar përcaktimeve të nenit 1, pika 2/d të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “2. Qëllimi i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”, do të jetë më mirë për autoritetin kontraktor ta verifikojë një fakt të tillë duke ju vënë në dispozicion dokumentacionin i cili mund të verifikohet lehtësisht nga ana juaj, sikurse keni verifikuar on-line vetëm dokumentacionin tonë me qëllimin final skualifikimin tonë.

Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përdorur dy standarde për vlerësimin e ofertave, pasi ka kualifikuar një ofertë e cila nuk plotëson kërkesën për kualifikim të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.f të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër arsyeja e tretë e skualifikimit nuk qëndron, pasi sipas skedës teknike dhe produktit “METAL CARE” i cili plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por dhe qëllimin e blerjes së këtij produkti nga ana e entit prokurues, ky produkt përdoret dhe mbi sipërfaqe druri (referojuni skedës teknike sipas parashtrimeve më sipërme), si dhe enti prokurues të bëjë provën faktike lidhur me përdorimin e saj mbi suva, ndërkohë që produkti Holz und Metal 270 i ofruar nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar sipas skedës teknike nuk përdoret mbi sipërfaqe druri dhe mbi suva.

Arsyeja e katërt e skualifikimit:

4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastër. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom SHPK me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1.Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laprakë), Tiranë, 2.Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3.Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe

*përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.*

*Ne si ofertues vërejmë se arsyeja e skualifikimit është mosplotësimi i kriterit kualifikues të dhënë në pikën 2/e, të "Kriterëve të veçanta të kualifikimit" në Shtojcën 9.*

*Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarohet:*

*1. Në Shtojcën 9, "Kriterëve të veçanta të kualifikimit", pika 1/e të dokumenteve të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:*

*e) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim në kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar "5 Vërtetim OSHE OLVAHROM" ku në këtë dokument është pasqyruar vërtetimin i lëshuar nga Operatori i Shërbimit së Energjisë Elektrike, Dega Gjirokastrë me nr.739 prot, datë 31.08.2020 ku vërtetohet se kompania jonë nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike përfshirë dhe muajin korrik 2020, pra nuk kemi detyrime të maturuara të energjisë elektrike, sipas VKM NR.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.. Lidhur me adresat ku ushtrojmë aktivitetet ju sjellim në vëmendje që vërtetimi i mësipërm që kemi paraqitur i vërteton dhe pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike edhe për këto adresa dhe meqënëse ju të nderuar anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i bëni me shumë dëshirë verifikimet për kompaninë tonë (me qëllimin e mbrapshtë dhe korrupsiv të skualifikimit të ofertës sonë) ju ftojme që të verifikoni pranë OSHEE-së nëse kompania jonë është apo jo debitore përsa i përket pagimit të detyrimeve të energjisë elektrike. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kriteri i mësipërm kualifikues i përcaktuar nga ana juaj është i cili kërkon paraqitjen e një vërtetimi për pagimin e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, po ju bëjmë me dije se është plotësuar më së miri nga ana jonë duke paraqitur vërtetimin e kërkuar.*

*Për sa më sipër arsyeja e katërt e skualifikimit nuk qëndron, pasi vërtetimi i lëshuar nga Operatori i Shërbimit së Energjisë Elektrike, Dega Gjirokastrë me nr.739 prot, datë 31.08.2020 vërteton se shoqëria jonë "OL-VAHROM" SHPK dhe administratori i saj Ilia Bostanxhiu nuk kanë detyrime të maturuara të energjisë elektrike të papaguara sipas përcaktimit të VKM NR.914, datë 29.12.2019 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

*Arsyeja e pestë e skualifikimit:*

*5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për "Furçë për lyerje me gëlqere profesionale" [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin "Wall Brushes and White Wash Brushes", të prodhuesit Token Tooling. Skeda e këtij nuk*

është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

Ne si ofertues vërejmë se arsyeja e skualifikimit është mosplotësimi i kriterit kualifikues të dhënë në pikën 2/3/e, të “Kriterëve të veçanta të kualifikimit” në Shtojcën 9.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarohet:

1. Në Shtojcën 9, “Kriterëve të veçanta të kualifikimit”, pika 2/3/e të dokumenteve të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:

e) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli të kërkuara në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit..

Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim ne kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “Skede teknike furce gelqere”, dokument origjinal (i cili nga skanimi duket bardhë e zi) i cili pasqyron një fragment të katalogut të prodhuesit TOKEN, i cili është i përkthyer dhe noterizuar, si dhe njëkohësisht është dorëzuar edhe mostra përkatëse e cila i plotëson të gjitha specifikimet teknike të dhëna nga enti prokurues, të tilla si: përmasat dhe lloji i qimeve të furçës të cilat janë qime natyrale, duke e plotësuar kërkesën për kualifikim të entit prokurues.

Lidhur me aludimin se: “Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim.”, ju bëjmë me dije se skeda teknike është origjinale dhe se nga cilësia e skanimit, si dhe nga dashakeqësia dhe dëshira për të bërë dëm ekonomik duke kualifikuar një operator që ka ofertë 20.000.000 leke te vjetra më të lartë ju duket sikur është fotokopje ndërkohe që është origjinale, ndërsa lidhur me pretendimin që është fragment katalogu i marrë nga Tolsentools është si rezultat i skanimit pasi poshtë kësaj letrë kur është skanuar ka qenë një dokument tjetër i cili ishte në radhë për tu skanuar.

Ndërkohë meqenësë më datë 06.10.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kërkoi kohë për verifikim dhe që në të vërtetë siç po rezulton vetëm verifikime nuk ka bërë, por na skualifikon padrejtësisht, ju kërkohet që të bëni verifikimet e nevojshme për këtë furçë, të cilën për hir të vertetës ofertuesi i vetëm i kualifikuar nga ana juaj nuk e ka paraqitur sikurse kërkohet në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit dhe që po e shtjellojmë më poshtë.

Gjithashtu sikurse ju përmendëm dhe në krye të ankesës më datë 21.09.2020, në momentin e dorëzimit të ofertave (fazë e cila për hir të së vërtetës është i vetmi moment i pastër dhe jokorruptiv i entit prokurues) i cili u bë në prani të të gjithë shoqërive pjesëmarrëse, fazë e cila është e filmuar nga ana jonë konstatuam se ofertuesi i vetëm i kualifikuar nga ana juaj “Gentian Horieti” p.f për produktin me numër rendor.18 në Shtojcën 10 “18. Furça për lyerje me gëlqere profesionale” ka dorëzuar furçe të prodhuesit ROLLEX S.A Greqi, cili sipas konfirmimit (DEKLARATËS) të bërë prej tij deklaroi se nuk prodhon furçe gëlqere me qime natyrale, ndërkohë që më datë 21.09.2020 kur dorëzua mostrat konstatuam se mostra e paraqitur për këtë artikull nuk ishte me qime natyrale, por me qime sintetike, jo me përmasat e kërkuara por me përmasa 2 herë më të vogla, si dhe nuk ishte me bisht druri, por me bisht dhe trup plastik (PVC), jo vetëm duke mosplotësuar kërkesën për kualifikim, por edhe ka mashtruar në lidhje me mostrën e kërkuar për artikullin me numër rendor 17 në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit. (bashkëlidhur deklarata e prodhuesit ROLLEX S.A Greqi) Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përdorur dy standarde për vlerësimin e ofertave, pasi ka kualifikuar një ofertë e cila nuk plotëson kërkesën për kualifikim të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.f të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër arsyeja e pestë e skualifikimit nuk qëndron, pasi skeda teknike e paraqitur është origjinale dhe e përkthyer e noterizuar, ndërkohë që mostra e paraqitur përputhet jo vetëm me specifikimet teknike por edhe me skedën teknike, pasi është me përmasat e kërkuara, është me qime natyrale dhe për më tepër është e firmës prodhuese TOKEN.

Sipas skedës teknike, e cila është origjinale e përkthyer dhe noterizuar dhe produktit “Furçë gëlqere token”, ndërkohë që produkti furçë gëlqere rollex i ofruar nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar nuk plotëson specifikimet teknike.

II. kërkojmë skualifikimin e ofertës së ofertuesit “Gentian Horieti” p.f për arsyet e mëposhtme:

Sikurse ju përmendëm dhe në krye të ankesës më datë 21.09.2020, në momentin e dorëzimit të ofertave (fazë e cila për hir të së vërtetës është i vetmi moment i pastër dhe jokorruptiv i entit prokurues) i cili u bë në prani të të gjithë shoqërive pjesëmarrëse, fazë e cila është e filmuar nga ana jonë konstatuam se ofertuesi i vetëm i kualifikuar nga ana juaj “Gentian Horieti” p.f ka dorëzuar mostrat si më poshtë:

- Për artikullin “3. STUKO PATINIMI” ka dorëzuar produktin ACRYL SPACHTEL, i cili nuk plotëson specifikimet teknike, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikullin “17. KOLLE SPECIALE ANTI LAGËSHIRË (hidroizolues)” ka dorëzuar produktin WERBERTEC AQUASTOP 2K të prodhuar nga kompania SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA, i cili nuk plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por edhe standardin e kërkuar, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikullin “15. Rrula komplet për përdorim profesional për lyerje me bojë vaji ose zmalto” ka dorëzuar produktin e prodhuar nga kompania ROLLEX S.A Greqi, produkt i cili nuk plotëson specifikimet teknike, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.

- Për artikullin “18. Furça për lyerje me gëlqere profesionale.” ka dorëzuar produktin e prodhuar nga kompania ROLLEX S.A Greqi, produkt i cili jo vetëm nuk plotëson specifikimet teknike, por edhe ka mashtruar lidhur me këtë produkt, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikullin “8. Kodar 5 ml zgjatues për bishtat e furçave dhe rrulave.” ka dorëzuar produktin e prodhuar nga kompania ROLLEX S.A Greqi, produkt i cili jo vetëm nuk plotëson specifikimet teknike, por edhe ka mashtruar lidhur me këtë produkt, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikullin “7. BOJË ZMALTO” ka dorëzuar produktin Holz und Metal, i cili nuk plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por edhe standardin e kërkuar, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikullin “5. pigmente” ka dorëzuar produktin dc basic i cili nuk plotëson jo vetëm specifikimet teknike, por edhe standardin e kërkuar, fakt të cilin do e shtjellojmë më poshtë.
- Për artikujt “1. bojë fasade (akrilike) me ngjyrë cilësi e pare”, “6. bojë hidromat”, “5. pigmente”, “4. bojë hidroplastike” ka dorëzuar përkatësisht produktet alpen profi 32; harmony; fc basic; picasso profi 05 të cilat nuk justifikojnë as cilësinë dhe as çmimin, të cilën do e shtjellojmë më poshtë.

Më poshtë po ju paraqesim pretendimet dhe faktet tona lidhur me mosplotësimin e kërkesave për kualifikim të pikave 2.3.e, 2.3.f dhe 2.3.h të dokumenteve të tenderit nga ana e ofertuesit të vetëm të kualifikuar:

1- Produkti ACRYL SPACHTEL nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar skedës teknike të publikuar nga prodhuesi DAST (te cilen mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.dast.eu/acryl-spachtel/>) dhe të bashkëlidhur kësaj ankese, vërehet se nuk plotëson standardin SSH EN 998-1:2016, pasi në të përmendet vetëm standardi EN 998-1, pa u përcaktuar viti i standardit.

2- Produkti WEBERTEC AQUASTOP 2K nuk plotëson specifikimet teknike, pasi si tregtar në fushën e materialeve të ndërtimit blemë në treg produktin e sipërpërmendur (bashkëlidhur fatura tatimore e blerjes, filmimet në CD ku anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për rrulat, si dhe fotot), i cili nga ana e shitesit na u shoqërua sëbashku me skedën teknike dhe 2 (dy) raporte testimi (bashkëlidhur skeda teknike dhe raportet e testimi) si më poshtë:

- Referuar skedës teknike e cila është në gjuhën shqipe, po ju bëjmë me dije se ky produkt është material hidroizolues, por jo kollë (pra që të ketë veti ngjitëse), fakt të cilin mund ta verifikoni dhe on-line ne faqen e WEB-it në linkun: <https://www.saint-gobain.al/products-and-systems/weber/kategorie-e-produkteve/hidroizolues>.

Gjithashtu ky produkt nuk plotëson standardin SSH EN 14891:2017, pasi sipas raporteve të testimi ME NUMËR, PTD-19.40/11.11.2019 dhe PTD-19.39/11.11.2019, të kryera nga laboratorit i testimi Building Research Institue-NISI, Bullgari, vërehet se produkti WEBERTEC AQUASTOP 2K është testuar dhe plotëson standardin EN 14891:2012 dhe jo standardin e kërkuar EN 14891:2017, ndërkohë që referuar dhe faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (në linkun:

[http://www.gov.al/standard/?ics\\_id=&national\\_comittee\\_id=&directive\\_id=&standard\\_code=SS\\_H+EN+14891%3A2012+&Submit=Kërko](http://www.gov.al/standard/?ics_id=&national_comittee_id=&directive_id=&standard_code=SS_H+EN+14891%3A2012+&Submit=Kërko)), konstatohet se standardi EN 14891:2012 është shfuqizuar. Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

3- Produkti "15. Rrula komplet për përdorim profesional për lyerje me bojë vaji ose zmalto" nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, u konstatua nga ana jonë se ky produkt nuk e kishte bishtin të gjatë në përmasat e kërkuara, nuk e kishte diametrin e rullit  $\Phi 15\text{mm}$  dhe më e rëndësishmja ruli nuk ishte me qime prej leshi natyral (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për rrulat, si dhe fotot), por ishte me qime sintetike, duke mosplotësuar specifikimet teknike të Shtojcës 10 dhe kriterin kualifikues të pikës 2.3.e të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit. Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

4- Produkti "18. Furça për lyerje me gëlqere profesionale." nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për furcën për lyerje me gëlqere, si dhe fotot) u konstatua nga ana jonë se ky produkt nuk e kishte bishtin prej druri, por e kishte bishtin dhe trupin prej plastike (PVC) dhe më e rëndësishmja është që ky produkt nuk ishte me qime natyrale, por me qime sintetike dhe akoma më tej nuk ishte më përmasat e kërkuara, por me përmasa shumë më të vogla. Gjithashtu konstatuam se ky produkt ishte i kompanisë prodhuese "ROLLEX" S.A, Greqi dhe duke qenë se ne jemi distributor të autorizuar të kësaj kompanie ju drejtuam asaj lidhur me këtë produkt, e cila nga ana e saj me anë të një deklarate (Bashkëlidhur deklarata) na konfirmon se nuk prodhon furçe të kësaj natyre (pra furçe gëlqere me qime natyrale, me bisht druri dhe përmasa 25-30cmx10-12cmx10-15cm).



Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsidratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

5- Produkti "8. Kodar 5 ml zgjatues për bishtat e furçave dhe rrulave" i paraqitur nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar është i fallsifikuar, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, u konstatua nga ana jonë se ky produkt ishte prej alumini, me përmasë 5 ml dhe me 3 (tre) hapje, por konstatuam se mostra e paraqitur ishte e kompanisë prodhuese "ROLLEX" S.A Greqi (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për kodarin 5 ml të gjatë dhe me tre hapje, si dhe fotot), prandaj duke qenë se ne jemi distributor të autorizuar të kësaj kompanie ju drejtuam asaj lidhur me këtë produkt, e cila nga ana e saj me anë të një deklarate (Bashkëlidhur deklarata) na konfirmon se nuk prodhon kodar 5 ml të gjatë dhe me 3 (tre) hapje.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsidratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

6- Produkti Holz und Metal 270 nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar skedës teknike (bashkëlidhur skeda teknike) të publikuar nga prodhuesi DEUTCHCOLOR (të cilën mund ta shkarkoni në linkun: <https://www//deutschcolor.com/en/product/holz-und-metal-270/>, dhe të bashkëlidhur kësaj ankese skeda teknike e përkthyer dhe noterizuar), vërehet se ky produkt nuk plotëson kriterin e pikave 2.3.e dhe 2.3.h të dokumenteve të tenderit (rrjedhimisht edhe specifikimet teknike), pasi në rubrikën "RECOMMENDATIONS FOR USE It is recommended to be used as a paint on all metal surfaces that are intended for indoor and outdoor use. It is used for painting metal constructions that are intended for use in industrial environments, such as workshops, bridges, stairs, machinery, handrails, metal gates, etc. It is used for painting the fences made of wooden lath, wooden stairs, wooden handrails, etc.", pra ky produkt nuk gjen aplikim mbi suva.

Megjithatë i kërkojmë entit prokurues që të bëjnë verifikimet e nevojshme (sikurse në rastin e ofertës sonë lidhur me pikën 2 të skualifikimit), pasi në këtë rast ka fakte konkrete dhe akuzë të ngritur nga

ana e jonë lidhur me jo vetëm vërtetësinë e dokumentit (skedës teknike të paraqitur nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar), por dhe me faktin që duhet të rivendosë barazinë në trajtimin e ofertuesve.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

7- Produkti DC BASIC nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar skedës teknike (bashkëlidhur skeda teknike e përkthyer dhe noterizuar) të publikuar nga prodhuesi DEUTCHCOLOR (të cilën mund ta shkarkoni në linkun: <https://deutschcolor.com/en/product/holz-und-metal-270/>) dhe të bashkëlidhur kësaj ankese, vërehet se ky produkt nuk plotëson kriterin e pikave 2.3.e dhe 2.3.h të dokumenteve të tenderit (rrjedhimisht edhe specifikimet teknike), pasi në rubrikën "product properties

- Easily spread
- Strong painting capacity
- For indoor use", pra ky produkt nuk është për ngjyrosjen e bojës së fasadës (akrilike) ME NGJYRË cilësi e parë, pra nuk ngjyros bojë për përdorim të jashtëm.

Në specifikimet teknike në Shtojcën 10 për artikullin "5. Pigmente" janë dhënë specifikimet teknike si më poshtë:

## 5. PIGMENTE

Pigmente me bazë uji për ngjyrosjen e bojrave për ambientet e brendshme ashtu dhe ato të jashtme.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

NGJYRA	VIZKOZITETI	PH	DENSITETI NE 23°C
E ZEZE	1450-3100 cPs	5.5-9,5	1.65-1.80 g/cm <sup>3</sup>
E KUQE	1450-3100 cPs	5.5-9.5	1.80-2.20 g/cm <sup>3</sup>
E VERDHE	280-1550 cPs	5.0-9.0	1.00-1.20g/cm <sup>3</sup>
JESHILE	270- 1570 cPs	5.5-9,5	1.20-1.50g/cm <sup>3</sup>
BLU	1470- 2570 cPs	7.0-9,5	1.80-2.00 g/cm <sup>3</sup>
LEJLA	100- 1050 cPs	6,0-9,0	1.10-1.20 g/cm <sup>3</sup>
KAFE	270-1570 cpS	6.0-9.0	1.55-1.70gcm <sup>3</sup>

PËRMBAJTJA E VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 30g/l

PËRDORIMI: për brenda dhe për jashtë

PAKETIMI: 1-2 Litra

JETËGJATËSIA: jo më pak se 1 vit

MAGAZINIMI: +5°- +30°

Ndërkohë në skedën teknike (në gjuhën angleze të publikuar nën autoritetin e prodhuesit në faqen zyrtare të tij në linkun: file: <https://deutschcolor.com/en/product/dc-basic>) thuhet që përdoret vetëm për përdorim të brendshëm, ndërkohë që në specifikimet teknike të shtojcës 10 (të dhëna më sipër) kërkohet që pigmenti të përdoret dhe për ngjyrosjen e bojrave për ambiente të jashtme, si dhe po në skedën teknike thuhet që parametri VOC është  $\leq 50$  g/l, ndërkohë që në specifikimet teknike të shtojcës 10 (të dhëna më sipër) kërkohet që PËRMBAJTJA VOC të jetë  $\leq 30$  g/l, duke mos plotësuar kërkesën e entit prokurues për specifikimet teknike.

Gjithashtu theksojmë se ky pigment i ofruar (nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar) duke mos patur aftësi për ngjyrosjen e bojës për jashtë, jo vetëm nuk plotëson specifikimet teknike (sikurse i përmendëm më lartë), por edhe nuk arrin qëllimin kryesor që ka enti prokurues në realizimin e këtij tenderi, që është blerja e artikullit me numer rendor 1 "BOJES SË FASADËS (akrilike) ME NGJYRË CILËSI E PARË", e cila sikurse specifikohet në Shtojcën 10 është bojë fasade për përdorim të jashtëm, si dhe kërkohet që të blihet në shtatë ngjyra RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032), ndërkohë referuar Shtojcës 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit" sasia e kësaj bojë që kërkohet të blihet nga ana e entit është 30584 kg, një sasi e konsiderueshme.

Gjithashtu lidhur me faktin që produkti DC BASIC nuk plotëson specifikimet teknike ju bëjmë me dije se ky pigment është BOJË E NGJYROSUR (kjo e vërtetuar me mostrën të cilën ju e administroni si ent prokurues, ku e keni dhe të filmuar në CD bashkëlidhur ankeses, ku në etiketë se: thuhet përbërja e këtij pigment i cili është: emulsion paint based on 100% pure acrylic copolymer, që në shqip përkthehet bojë e përzierë bazuar në kopolimer akriliku 100% të pastër, që në zhargonin e përditshëm i quajmë pigmente dore) e cila përdoret për lyerje direkt të sipërfaqeve të murit ose për të ngjyrosur (realizimin e ngjyrave të lehta) të bojrave për përdorim të brendshëm, por kurrësi për bërjen e bojrave RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032) dhe për më tepër që pigmentet e vërteta RAL që kërkohen nga ana juaj dhe që tregton firma DEUTSCHCOLOR nuk është produkti DC BASIC, por është produkti COLORANT (dhe konkretisht: COLORANT DC 10 "PIGMENT PORTOKALLI"; COLORANT DC 3 "PIGMENT I VERDHË"; COLORANT DC 16 "PIGMENT VJOLLCË" etj, bashkëlidhur foto e produktit COLORANT) dhe për më tepër që produkti DC BASIC e ka vlerën në treg 480 lekë/litër (pa-TVSH), fakt i cili tregon jo vetëm cilësinë e këtij produkti (bashkëlidhur fatura e blerjes), por dhe mashtrimin që po i bëhet entit prokurues (dhe në këtë rast shpërdorimit të parasë publike) duke i ofruar bojë të ngjyrosur dhe jo pigment.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishme për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

*Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.*

*8- Bojrat e murit të ofruara nga ofertusi i vetëm i kualifikuar nuk plotësojnë kërkesat e cilësisë, duke ju paraqitur fakte si më poshtë:*

*Ky ofertues ka ofertuar me produktet:*

- 1. Për artikullin “1. BOJË FASADE (akrilike) ME NGJYRË Cilësi e parë” të kërkuar në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit ka dorëzuar produktin ALPEN PROFİ 32 e cila është cilësia e tretë e prodhuesit, të cilën do e shtjellojmë më poshtë.*
- 2. Për artikullin “6. BOJË HIDROMAT” ka dorëzuar produktin HARMONY e cila është cilësia më e dobët e prodhuesit, të cilën do e shtjellojmë më poshtë.*
- 3. Për artikullin “5. PIGMENTE” ka dorëzuar produktin DC BASIC e cila nuk është pigment me bazë uji për ngjyrosjen e bojrave për ambientet e brendshme ashtu dhe ato të jashtme, të cilën do e shtjellojmë më poshtë.*
- 4. Për artikullin “4. BOJË HIDROPLASTIKE” ka dorëzuar produktin PICASSO PROFİ 05, të cilën do e shtjellojmë më poshtë.*

*Nga një shikim i vëmëndshëm i faqes së internetit të prodhuesit DEUTSCHCOLOR, si dhe nga përvoja e gjatë në tregun e prodhimit dhe tregimit të bojrave i bëjmë me dije entit prokurues se ofertuesi i vetëm i kualifikuar ka ofruar produkte të cilat janë cilësia e tretë që tregton prodhuesi dhe konkretisht:*

- 1- Produkti ALPEN PROFİ 32 është cilësia e tretë (ekonomike) e bojës akrilike që prodhon kompania DEUTSCHCOLOR, pasi cilësi e parë është produkti ALPEN CLASSIC QL11, fakt i cili vërtetohet shumë lehtë në Faqen WEB të kësaj kompanie në linkun: <https://www.deutschcolor.com/en/product-category/paints/outdoor-paints/>, ndërkohë që në dokumentet e tenderit kërkohet cilësia e parë.*

*Gjithashtu ky produkt në tregun me pakicë ka çmimin 190 lekë për kilogram (ndërkohë që ofertuesi i vetëm i kualifikuar nëse do të lidhë kontratë do të marrë nga prodhuesi çmim edhe më të ulët se ai i ofertuar, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me blerjen e një sasive të madhe boje, ndërkohë që i sugjerojmë që të rivlerësojë procedurën, pasi ka kualifikuar një ofertues i cili çmimin e ka shumë herë më të lartë se çmimi real në treg dhe që enti prokurues nëse do të blentë drejtëpërdrejtë (ndonëse do të shkelte parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar) do të kursente fonde të mjaftueshme për të realizuar shërbime të tjera në shërbim të qytetarëve, pasi diferenca midis çmimit që përmëndëm më lart dhe çmimit të ofruar në ofertë nga ofertuesi i vetëm*

*i kualifikuar është jo vetëm mospërdorim eficient i parasë publike dhe për më tepër është objekt i verifikimit nga ana e krimit ekonomik dhe prokurorisë, por humb dhe qëllimin e kryerjes së kësaj procedure prokurimi, pasi në vend që të marrë cilësinë më të mirë me çmim sa më të mirë, po merr cilësinë më të keqe me çmimin më të shtrenjtë, ndërkohë që produkti i ofruar nga ana jonë është cilësi e parë dhe me çmimi real dhe norma fitimi normale (fakt të cilin ne jemi gati tua argumentojme duke ju vënë në dispozicion faturat e blerjes).*

*Për më tepër ky produkt i ofruar nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar ka raport lysterje metrash katrorë për litër rreth 30% më të vogël se produkti i ofruar nga ana jonë, duke i sjellë dëm entit prokurues jo vetëm në sasinë totale të metrave që do të lyeje (duke lyster më pak çerdhe, kopshte, shkolla), por dhe duke blerë mallra me cilësi të dobët dhe me çmim shumë herë më të madh se i tregut me pakicë, çka dhe njëherë ju kujtojmë se është objekt i verifikimit të krimit ekonomik dhe prokurorisë.*

- 2- *Produkti HARMONY është cilësia e tretë (ekonomike,) e bojës hidromat që prodhon kompania DEUTSCHCOLOR, pasi cilësi e parë është produkti HYDRO O2, fakt I cili vërtetohet shumë lehtë në Faqen WEB të kësaj kompanie në linkun: <https://deutschcolor.com/en/product-category/paints/indoor-paints/>.*

*Gjithashtu ky produkt në tregun me shumicë ka cmimin 90 lekë për kilogram (ndërkohë që ofertuesi i vetëm i kualifikuar nëse do të lidhe kontratë do të marrë nga prodhuesi çmim edhe më të ulët pasi në këtë rast kemi të bëjmë me blerjen e një sasive të madhe boje) ndërkohë që i sugjerojmë që të rivlerësojë procedurën, pasi ka kualifikuar një ofertues i cili çmimin e ka shumë herë më të lartë se çmimi real në treg dhe që enti prokurues nëse do të blinte drejtëpërdrejtë (ndonëse do të shkelte parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar) do të kursente fonde të mjaftueshme për të realizuar shërbime të tjera në shërbim të qytetarëve, pasi diferenca midis çmimit që përmendëm më lart dhe çmimit të ofruar në ofertë nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar është jo vetëm mospërdorim eficient i parasë publik dhe për më tepër është objekt i verifikimit nga ana e krimit ekonomik dhe prokurorisë, por humb dhe qëllimin e kryerjes së kësaj procedure prokurimi, pasi në vend që të marri cilësinë më të mirë me çmim sa më të mirë, po merr cilësinë më të keqe me çmimin më të shtrenjtë, ndërkohë që produkti i ofruar nga ana jonë është cilësi e parë dhe me çmimi real dhe norma fitimi normale (fakt të cilin ne jemi gati tua argumentojme duke ju vënë në dispozicion faturat e blerjes).*

*Për më tepër ky produkt i ofruar nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar ka raport lysterje metrash katrorë për litër rreth 30% më të vogël se produkti i ofruar nga ana jonë, duke i sjellë dëm entit prokurues jo vetëm në sasinë totale të metrave që do të lyeje (duke lyster më pak çerdhe, kopshte, shkolla), por dhe duke blerë mallra me cilësi të dobët dhe me çmim shumë herë më të madh se i tregut me pakicë, çka dhe njëherë ju kujtojmë se është objekt i verifikimit të krimit ekonomik dhe prokurorisë.*

- 3- *Produkti PICASSO PROFI 05 është cilësia e tretë (ekonomike,) e bojës hidroplastike (plastike) që prodhon kompania DEUTSCHCOLOR, pasi cilësi e parë është produkti PICASSO PROFI VN 35, fakt i cili vërtetohet shumë lehtë në Faqen WEB të kësaj kompanie në linkun: <https://deutschcolor.com/en/product-category/paints/indoor-paints/>.*

Gjithashtu ky produkt në tregun me pakicë ka çmimin 160 lekë për kilogram (ndërkohë që ofertuesi i vetëm i kualifikuar nëse do të lidhe kontratë do të marrë nga prodhuesi çmim edhe më të ulët pasi në këtë rast kemi të bëjmë me blerjen e një sasive të madhe boje) ndërkohë që i sugjerojmë që të rivlerësojë procedurën, pasi ka kualifikuar një ofertues i cili çmimin e ka shumë herë më të lartë se çmimi real në treg dhe që enti prokurues nëse do të blinte drejtëpërdrejtë (ndonëse do të shkelte parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar) do të kursente fonde të mjaftueshme për të realizuar shërbime të tjera në shërbim të qytetarëve, pasi diferenca midis çmimit që përmendëm më lart dhe çmimit të ofruar në ofertë nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar është jo vetëm mospërdorim eficient i parasë publike dhe për më tepër është objekt i verifikimit nga ana e krimit ekonomik dhe prokurorisë, por humb dhe qëllimin e kryerjes së kësaj procedure prokurimi, pasi në vend që të marri cilësinë më të mirë me çmim sa më të mirë, po merr cilësinë më të keqe me çmimin më të shtrenjtë, ndërkohë që produkti i ofruar nga ana jonë është cilësi e parë dhe me çmimi real dhe norma fitimi normale (fakt të cilin ne jemi gati tua argumentojme duke ju vënë në dispozicion faturat e blerjes).

Për më tepër ky produkt i ofruar nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar ka raport lysterje metrash katrorë për litër rreth 30% më të vogël se produkti i ofruar nga ana jonë, duke i sjellë dem entit prokurues jo vetëm në sasinë totale të metrave që do të lyeje (duke lyster më pak çerdhe, kopshte, shkolla), por dhe duke blerë mallra me cilësi të dobët dhe me çmim shumë herë më të madh se i tregut me pakicë, çka dhe njëherë ju kujtojmë se është objekt i verifikimit të krimit ekonomik dhe prokurorisë.

- 4- Por shkelja më e rëndë e entit prokurues është pranimi dhe kualifikimi i produktit DC BASIC sikuse e shtjelluam edhe më lartë nuk është pigment RAL, si dhe nuk ngjyros bojrat për jashtë, por është bojë e ngjyrosur që në zhargonin e përditshëm quhet “PIGMENT DORE”, ndërsa pigmenti RAL i prodhuesit DEUTSCHCOLOR është produkti “DC COLORANT”, fakt të cilin mund ta vërtetoni jo vetëm me një testim të thjeshtë tregu, por edhe duke ju drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me skedat teknike të prodhimit që ka të depozituara kompania DEUTSCHCOLOR, si dhe argumentimit të fondit limit të bërë nga ana e njësisë së prokurimit të entit prokurues.

Gjithashtu flagranca dhe abuzimi në pranimin e këtij produkti nga ana e entit prokurues është fakti se ky produkt në tregun me pakicë ka çmimin me pakicë 316,16 lekë për litër pa - TVSH (fakt të cilin e mbështesim duke ju vënë bashkëlidhur faturën tatimore të lëshuar nga një shitës i autorizuar i kompanisë DEUTSCHCOLOR për produktet që bleu aty kompania jonë), ndërkohë që ofertuesi i vetëm i kualifikuar nëse do të lidhe kontratë do të marrë nga prodhuesi çmim edhe më të ulët pasi në këtë rast kemi të bëjmë me blerjen e një sasive të madhe boje, ndërkohë që i sugjerojmë që të rivlerësojë procedurën, pasi ka kualifikuar një ofertues i cili çmimin e ka shumë herë më të lartë se çmimi real në treg dhe që enti prokurues nëse do të blinte drejtëpërdrejtë (ndonëse do të shkelte parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar) do të kursente fonde të mjaftueshme për të realizuar shërbime të tjera në shërbim të qytetarëve, pasi diferenca midis çmimit që përmendëm më lart dhe çmimit të ofruar në ofertë nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar është jo vetëm mospërdorim eficient i parasë publik dhe për më tepër është objekt i verifikimit nga ana e krimit ekonomik dhe prokurorisë, por humb dhe qëllimin e kryerjes së kësaj procedure prokurimi, pasi në vend që të marri cilësinë më të mirë me çmim sa më të mirë, jo vetëm që nuk po merr cilësinë

më të keqe, por po merr produkt tjetër për tjetër me çmimi disafish më të shtrenjtë, ndërkohë që produkti i ofruar nga ana jonë është pigment kompjuteri RAL, me fuqi të lartë ngjyuese, jo vetëm për ngjyrosjen e bojrave për përdorim të brendshëm, por edhe për ngjyrosjen e bojrave për përdorim të jashtëm.

Gjithashtu i kërkojmë dhe sfidojmë entin prokurues që në zbatim të kërkesave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë sonë, në prani të specialistëve të entit prokurues, si dhe në prani të përfaqësuesve dhe specialistëve të kompanisë fituese të bëjë provat reale me këtë produkt, duke bërë provën në realitet me një mostër (p.sh realizimi e njëres nga ngjyrat RAL të parashikuar në Shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit për produktin me numër rendor nr.1) dhe të shohim rezultatin konkret nëse sipas skedës teknike ky produkt është pigment RAL për bojra fasade (akrilike), pasi një nga qëllimet për të cilat kërkohet mostra është dhe plotësimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.h të “Kritereve të veçanta për kualifikim” të Shtojcës 9 ku është përcaktuar nga ana juaj se: “Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”, pra përputhja e mostrës me specifikimet teknike dhe konkretisht me specifikimin teknike të dhënë në shtojcën 10, për artikullin me numër rendor nr.5 ku është përcaktuar: “Pigmente me bazë uji për ngjyrosjen e bojrave për ambientet e brendshme ashtu dhe ato të jashtme.”, bëhet jo vetëm nëpërmjet dokumentacionit (pasi dokumentacioni mund të jetë i rremë), jo vetëm me kqyrjes së jashtme të mostrës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me llojin e paketimit, me shkrimet në ambalazh, sasinë e produktit, konfeksionin, por edhe nëpërmjet realizimit të provave reale me produktin për të parë nëse vetitë fizike dhe mekanike që ka ky produkt realizojnë apo jo qëllimin e blerjes së tij nga ana e entit prokurues lidhur me (plotësimin e specifikimeve teknike) faktin nëse ngjyros sipas ngjyrave ral të dhënë në Shtojcën 10 Bojën e fasadës..

Ndërkohë lidhur me kërkesën tonë që të bëhen provat faktike për përdorimin mbi sipërfaqe druri dhe mbi suva të produktit të ofruar nga ana jonë, kërkojmë dhe ftojme entin prokurues që të bëjë provën faktike dhe me produktin e ofertuesit të vetëm të skualifikuar nga ana juaj.

Si konkluzion për pikën II të ankesës kërkojmë që të skualifikohet ofertuesi Gentian Horieti p.f, pasi nuk plotëson kërkesat për kualifikim, si dhe të verifikohet dokumentacioni i dorëzuar, pasi sipas dokumenteve të dorëzuar nga ana jonë konstatohet se disa produktet e ofruara të ofruara prej tij nuk janë të prodhuesve të cilët ai i ka deklaruar në ofertën teknike, si dhe dokumentacioni dhe produktet e tjera nuk plotësojnë si specifikimet teknike ashtu dhe standardet e kërkuara dje për më tepër janë mallra jo cilësorë dhe me cmim shumë herë më të lartë se cmimi me pakicë i tregut të bojrave, pra në këtë rast nuk enti prokurues edhe nëse do të blinte drejtëpërdrejtë produktet e ofruara në tregun e lirë (ndonëse do të shkelte ligjin e prokurimit publik) do të blinte shumë herë më lirë të njëjtin produkt që ka ofruar ofertuesi Gentian Horieti p.f.

Kërkojmë mbetjen të skualifikuar të ofertuesit DEUTSCHCOLOR SHA për arsyet e dhena nga komisioni i vlerësimit të ofertave, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për mospërmbushje të kritereve 2.3.e dhe 2.3.f të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, lidhur me artikujt me numër rendor 7, 8, 5, 15 dhe 18 të Shtojcës 10 të dokumenteve të tenderit dhe konkretisht:

*Produkti “15. Rrula komplet për përdorim profesional për lyerje me bojë vaji ose zmalto” nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, u konstatua nga ana jonë se ky produkt nuk e kishte bishtin të gjatë në përmasat e kërkuara, nuk e kishte diametrin e rullit  $\Phi 15\text{mm}$  dhe më e rëndësishmja ruli nuk ishte me qime prej leshi natyral (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për rrulat, si dhe fotot), por ishte me qime sintetike, duke mos plotësuar specifikimet teknike të Shtojcës 10 dhe kriterin kualifikues të pikës 2.3.e të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.*

*Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishëm për tu marrë në konsidratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.*

*Produkti “18. Furça për lyerje me gëlqere profesionale.” nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për furcën për lyerje me gëlqere, si dhe fotot) u konstatua nga ana jonë se ky produkt nuk e kishte bishtin prej druri, por e kishte bishtin dhe trupin prej plastike (PVC) dhe më e rëndësishmja është që ky produkt nuk ishte me qime natyrale, por me qime sintetike dhe akoma më tej nuk ishte më përmasat e kërkuara, por me përmasa shumë më të vogla.*

*Gjithashtu konstatoam se ky produkt ishte i kompanisë prodhuese “ROLLEX” S.A, Greqi dhe duke qenë se ne jemi distributor të autorizuar të kësaj kompanie ju drejtuam asaj lidhur me këtë produkt, e cila nga ana e saj me anë të një deklaratë (Bashkëlidhur deklarata) na konfirmon se nuk prodhon furçe të kësaj natyre (pra furçe gëlqere me qime natyrale, me bisht druri dhe përmasa 25-30cmx10-12cmx10-15cm).*

*Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishme për tu marrë në konsidratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.*



Produkti “8. Kodar 5 ml zgjatues për bishtat e furçave dhe rrulave” i paraqitur nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar është i fallsifikuar, pasi referuar momentit të dorëzimit të mostrave më datë 21.09.2020, u konstatua nga ana jonë se ky produkt ishte prej alumini, me përmasë 5 ml dhe me 3 (tre) hapje, por konstatuam se mostra e paraqitur ishte e kompanisë prodhuese “ROLLEX” S.A Greqi (bashkëlidhur filmimet në CD ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tregon dhe përmend emrin e prodhuesit për kodarin 5 ml të gjatë dhe me tre hapje, si dhe fotot), prandaj duke qenë se ne jemi distributor të autorizuar të kësaj kompanie ju drejtuam asaj lidhur me këtë produkt, e cila nga ana e saj me anë të një deklaratë (Bashkëlidhur deklarata) na konfirmon se nuk prodhon kodar 5 ml të gjatë dhe me 3 (tre) hapje.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishme për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

Produkti Holz und Metal 270 nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar skedës teknike (bashkëlidhur skeda teknike) të publikuar nga prodhuesi DEUTCHCOLOR (të cilën mund ta shkarkoni në linkun: <https://www/deutschcolor.com/en/product/holz-und-metal-270/>, dhe të bashkëlidhur kësaj ankese skeda teknike e përkthyer dhe noterizuar), vërehet se ky produkt nuk plotëson kriterin e pikave 2.3.e dhe 2.3.h të dokumenteve të tenderit (rrjedhimisht edhe specifikimet teknike), pasi në rubrikën “RECOMMENDATIONS FOR USE It is recommended to be used as a paint on all metal surfaces that are intended for indoor and outdoor use. It is used for painting metal constructions that are intended for use in industrial environments, such as workshops, bridges, stairs, machinery, handrails, metal gates, etc. It is used for painting the fences made of wooden lath, wooden stairs, wooden handrails, etc.”, pra ky produkt nuk gjen aplikim mbi suva.

Megjithatë i kërkojmë entit prokurues që të bëjnë verifikimet e nevojshme (sikurse në rastin e ofertës sonë lidhur me pikën 2 të skualifikimit), pasi në këtë rast ka fakte konkrete dhe akuzë të ngritur nga ana e jonë lidhur me jo vetëm vërtetësinë e dokumentit (skedës teknike të paraqitur nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar), por dhe me faktin që duhet të rivendosë barazinë në trajtimin e ofertuesve.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishme për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

Produkti DC BASIC nuk plotëson specifikimet teknike, pasi referuar skedës teknike (bashkëlidhur skeda teknike e përkthyer dhe noterizuar) të publikuar nga prodhuesi DEUTCHCOLOR (të cilën mund ta shkarkoni në linkun: <https://deutschcolor.com/en/product/holz-und-metal-270/>) dhe të bashkëlidhur kësaj ankese, vërehet se ky produkt nuk plotëson kriterin e pikave 2.3.e dhe 2.3.h të dokumenteve të tednderit (rrjedhimisht edhe specifikimet teknike), pasi në rubrikën "PRODUCT PROPERTIES

- Easily spread
- Strong painting capacity
- For indoor use", pra ky produkt nuk është për ngjyrosjen e bojës së fasadës (akrilike) ME NGJYRË cilësi e parë, pra nuk ngjyros bojë për përdorim të jashtëm.

Në specifikimet teknike në Shtojcën 10 për artikullin "5. Pigmente" janë dhënë specifikimet teknike si më poshtë:

#### PIGMENTE

Pigmente me bazë uji për ngjyrosjen e bojrave për ambientet e brendshme ashtu dhe ato të jashtme.

#### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

NGJYRA	VISKOZITETI	PH	DENSITETI NE 23°C
E ZEZE	1450-3100 cPs	5.5-9,5	1.65-1.80 g/cm <sup>3</sup>
E KUQE	1450-3100 cPs	5.5-9.5	1.80-2.20 g/cm <sup>3</sup>
E VERDHE	280-1550 cPs	5.0-9.0	1.00-1.20g/cm <sup>3</sup>
JESHILE	270- 1570 cPs	5.5-9,5	1.20-1.50g/cm <sup>3</sup>
BLU	1470- 2570 cPs	7.0-9,5	1.80-2.00 g/cm <sup>3</sup>
LEJLA	100- 1050 cPs	6,0-9,0	1.10-1.20 g/cm <sup>3</sup>
KAFE	270-1570 cpS	6.0-9.0	1.55-1.70gcm <sup>3</sup>

PËRMBAJTJA E VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 30g/l

PËRDORIMI: për brenda dhe për jashtë

PAKETIMI: 1-2 Litra

JETËGJATËSIA: jo më pak se 1 vit

MAGAZINIMI: +5°- +30°

Ndërkohë në skedën teknike (në gjuhën angleze të publikuar nën autoritetin e prodhuesit ne faqen zyrtare të tij në linkun: [file: https://deutschcolor.com/en/product/dc-basic](https://deutschcolor.com/en/product/dc-basic)) thuhet që përdoret vetëm për përdorim të brendshëm, ndërkohë që në specifikimet teknike të shtojcës 10 (të dhëna më sipër) kërkohet që pigmenti të përdoret dhe për ngjyrosjen e bojrave për ambiente të jashtme, si dhe po në skedën teknike thuhet që parametri VOC është ≤ 50 g/l, ndërkohë që në specifikimet teknike të shtojcës 10 (të dhëna më sipër) kërkohet që përmbajtja voc të jetë ≤ 30 g/l, duke mosplotësuar kërkesën e entit prokurues për specifikimet teknike.

Gjithashtu theksojmë se ky pigment i ofruar (nga ofertuesi i vetëm i kualifikuar) duke mos patur aftësi për ngjyrosjen e bojës për jashtë, jo vetëm nuk plotëson specifikimet teknike (sikurse i përmëndëm më lartë), por edhe nuk arrin qëllimin kryesor që ka enti prokurues në realizimin e këtij tenderi, që është blerja e artikullit me numer rendor 1 “BOJES SË FASADËS (akrilike) ME NGJYRË CILËSI E PARË”, e cila sikurse specifikohet në Shtojcën 10 është bojë fasade për përdorim të jashtëm, si dhe kërkohet që të blihet në shtatë ngjyra RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032), ndërkohë referuar Shtojcës 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” sasia e kësaj bojë që kërkohet të blihet nga ana e entit është 30584 kg, një sasi e konsiderueshme.

Gjithashtu lidhur me faktin që produkti DC BASIC nuk plotëson specifikimet teknike ju bëjmë me dije se ky pigment është BOJË E NGJYROSUR (kjo e vërtetuar me mostrën të cilën ju e administroni si ent prokurues, ku e keni dhe të filmuar në bashkëlidhur ankeses, ku në etiketë se: thuhet përbërja e këtij pigment i cili është: EMULSION PAINT BASED ON 100% PURE ACRYLIC COPOLYMER, që në shqip përkthehet BOJË E PËRZIERË BAZUAR NË KOPOLIMER ACRILIKU 100% TË PASTËR, që në zhargonin e përditshëm i quajmë pigmente dore) e cila përdoret për lyerje direkt të sipërfaqeve të murit ose për të ngjyrosur (realizimin e ngjyrave të lehta) të bojrave për përdorim të brendshëm, por kurrsesi për bërjen e bojrave RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032) dhe për më tepër që pigmentet e vërteta RAL që kërkohen nga ana juaj dhe që tregton firma DEUTSCHCOLOR nuk është produkti DC BASIC, por është produkti COLORANT (dhe konkretisht: COLORANT DC 10 “PIGMENT PORTOKALLI”; COLORANT DC 3 “PIGMENT I VERDHË”; COLORANT DC 16 “PIGMENT VJOLLCË” etj, bashkëlidhur foto e produktit COLORANT) dhe për më tepër që produkti DC BASIC e ka vlerën në treg 480 lekë/litër (pa-TVSH), fakt i cili tregon jo vetëm cilësinë e këtij produkti (bashkëlidhur fatura e blerjes), por dhe mashtrimin që po i bëhet entit prokurues (dhe në këtë rast shpërdorimit të parasë publike) duke i ofruar bojë të ngjyrosur dhe jo pigment.

Faktet e sipërpërmendura janë shumë të rëndësishme për tu marrë në konsideratë nga ana e entit prokurues, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me mosplotësim të kriterit kualifikues të dhënë në pikëat 2.3.e dhe 2.3.h të Shtojcës 9, të dokumenteve të tenderit, shkelje të parimit të barazisë në tendera sipas parashikimeve të nenit 2/a, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëse nuk marrin masa për të rivendosur barazinë në trajtimin dhe vlerësimin e ofertuesve sipas parashikimeve të nenit 258, të Ligjit nr.7895, datë 21.07.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Prandaj ky produkt nuk i plotëson kërkesat për kualifikim dhe ofertuesi i vetëm i kualifikuar duhet të skualifikohet.

Kërkojmë mbetjen të skualifikuar të ofertuesve I.D.K KONSTRUKSION SHPK dhe VILA DEKOR SHPK, për arsyet e skualifikimit të dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Si përfundim kërkojmë:

1- Pëzullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës sonë.

2- Rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke kualifikuar ofertën e kompanisë OL-VAHROM SHPK.

3- Rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke skualifikuar ofertuesin Gentian Horieti p.f, si dhe verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar prej këtij ofertuesi sipas pretendimeve në pikën II.

4- Rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke mbetur i skualifikuar si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertuesin DEUTSCHCOLOR SHA.

5- Rivlerësimin e procedurës duke mbetur të skualifikuar ofertuesit VILA DEKOR SHPK dhe I.D.K KONSTRUKSION SHPK për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

II.4.2. Në datën 02.11.2020 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 3884/4 i kthen përgjigje palës ankimuese “OL-Vahrom” SHPK duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.4.3. Në datën 10.11.2020 operatori ekonomik ankimues “OL-Vahrom” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën nr. 4255/1 prot, datë 23.11.2020 protokolluar me tonën me nr. 1466/2 prot. datë 24.11.2020, me objekt “Informacion”, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Nëpërmjet shkresës Nr.prot 1466/4, datë 19.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar OSHEE GROUP SHA, duke i kërkuar shprehimisht si vijon:

*Pranë institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa e një operatori ekonomik, në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje materiale bojaxhiu”, me nr. REF-67976-08-06-2020, me fond limit 66,666,580 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.*

*Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:*

1. *Kontratat e energjisë elektrike në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar “Ol-Vahrom” SHPK.*
2. *A rezulton të jetë subjekti tregtar “Ol-Vahrom” SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat “Lagjia “18 Shtatori”, Rr. “Birbilenj”, Z. K. 8541, Pasuria Nr. 14/014+1-1, Gjirokastër”; “Rruga e Durrësit”, pranë Doganës (Laparakë), Tiranë”; “Rr. “Selaudin Zorba”, ish Serat, Tiranë”; “Rruga e Dibrës”, Nr.403, Tiranë”?*

3. Nëse është përdorues në adresat e mësipërme, a ka patur detyrimin që subjekti tregtar “Ol-Vahrom” SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” ?

II.7. Në datën 06.05.2021 dhe datën 10.05.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1466/5 prot dhe 1466/7 prot shkresa e shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, pjesë e Grupit OSHEE me nr. 1831/1 prot., datë 04.05.2021 dhe nr. 1831/2 prot, datë 07.05.2021 me objekt: “Kthim përgjigje”, me përmbajtjen si më poshtë:

*Në përgjigje të shkresës Nr. 1466/4 Prot, datë 19.02.2021, të rregjistruar pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Nr. 1884 Prot, datë 22.02.2021 dhe trajtuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, me Nr. 1831 Prot, fatë 22.02.2021 me anë të së cilës kërkoni paraqitjen e informacionit, sqarojmë si vijon:*

*Ju bëjmë me dije se si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore – organizative që kanë ndodhur në shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, kontrata e energjisë elektrikedhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me të janë transferuar tek shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA pjesë e Grupit OSHEE. Në vijim çdo korrespondencë në lidhje me efektet e kontratës së energjisë elektrike do të trajtohet nga shoqëria Furnizuesi I Shërbimit Universal SHA.*

*Me gjeneralitetet subjekti “OL VAHROM” shpk, referuar të dhënave sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent titullar me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXX, në instancën Tiranë, në adresën A.S.Zorba.*

*Me gjeneralitetet subjekti “OL VAHROM” shpk, referuar të dhënave sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent përdorues me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXX, në instancën Gjirokastër.*

*Referuar deklaratës për përdorues pranë FSHU sqarojmë që subjekti “OL VAHROM” shpk ka paraqitur dokumentacionin e miratuar si më poshtë:*

- *Aplikim në KNK*
- *Dokument Pronësie të titullarit të kontratës*
- *ID e titullarit të kontratës*
- *Kontratë Qeraje*
- *ID përdoruesi*
- *QKB*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “OL-Vahrom” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen se: “Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9, ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastër. Nga shqyrtimi I Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom SHPK me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1. Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laprakë), Tiranë, 2.Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3.Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendndodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9. Lidhur me këtë arsye skualifikimi po sqarohet: 1. Në Shtojcën 9, “Kriterëve e veçanta të kualifikimi”, pika 1/e të dokumentave të tenderit nga enti prokurues është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë: e) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Për plotësimin e kësaj kërkesë për kualifikim në kemi dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentin e titulluar “5 Vërtetim OSHE OLVAHROM” ku në këtë dokument është pasqyruar vërtetimin i lëshuar nga Operatori i Shërbimit së Energjisë Elektrike, Dega Gjirokastër me nr.739 prot, datë 31.08.2020 ku vërtetohet se kompania jonë nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike përfshirë dhe muajin korrik 2020, pra nuk kemi detyrime të maturuara të energjisë elektrike, sipas VKM NR.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Lidhur me adresat ku ushtrojmë aktivitet ju sjellim në vëmendje që vërtetimi i mësipërm që kemi paraqitur i vërteton dhe pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike edhe për këto adresa dhe meqenëse ju të nderuar anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i bëni me shumë dëshirë verifikimet për kompaninë tonë (me qëllimin e mbrapshtë dhe korruptiv të skualifikimit të ofertës sonë) ju ftojme që të verifikoni pranë OSHEE-së nëse kompania jonë është apo jo debitore për sa i përket pagimit të detyrimeve të energjisë elektrike. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kriteri i mësipërm kualifikues i përcaktuar nga ana juaj është i cili kërkon paraqitjen e një vërtetimi për pagimin e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, po ju bëjmë me dije se është plotësuar më së miri nga ana jonë duke paraqitur vërtetimin e kërkuar. Për sa më sipër arsyeja e katërt e skualifikimit nuk qëndron, pasi vërtetimi i lëshuar nga Operatori i Shërbimit së Energjisë Elektrike, Dega Gjirokastër me nr.739 prot, datë 31.08.2020 vërteton se shoqëria jonë “OL-VAHROM” SHPK dhe administratori i saj Ilia Bostanxhiu nuk kanë detyrime të maturuara të energjisë elektrike të papaguara sipas përcaktimit të VKM NR.914, datë 29.12.2019 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta për Kualifikim” pika 1 gërma “e” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “OL-VAHROM” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Vërtetim debie nr. 739 prot., datë 31.08.2021, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. X. X, vërtetohet se kërkuesi OL-VAHROM SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën (me kod) XXXXXXXXXX , titullar / përdorues i së cilës/ave është z. X. X, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 31.08.2020 përfshirë vlerën e faturës koherente të muajit Korrik 2020.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

III.1.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.109, datë 21.10.2011 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji

*elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

III.1.7. KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “*OL VAHROM*” SHPK ka të bëjë përkatësisht me kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e tij me arsyen se: “*Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastrë. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom SHPK me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1. Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laparakë), Tiranë, 2. Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3. Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.”. Në kuadër të shqyrtimit administrative të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua nëpërmjet shkresës Nr. prot 1466/4, datë 19.02.2021, OSHEE GROUP SHA, duke i kërkuar informacion në lidhje me kontratat e energjisë elektrike për subjektin “*OL VAHROM*”, nëse është titullar ose përdorues për adresat e mësipërcituara në shkresë. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA., këtu e në vijim (OSHEE SHA), në datën 06.05.2021 dhe 07.05.2021 është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1831/1, 1831/2 prot., me objekt: “Kthim përgjigje”, drejtuar Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë në mënyrë të përmbledhur: **1- Me gjeneralitetet subjekti “OL VAHROM” SHPK, referuar të dhënave sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent titullar me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXX, në instancën Tiranë, në adresën A.S.Zorba. 2- Me gjeneralitetet subjekti “OL VAHROM” SHPK, referuar të dhënave sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent përdorues me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXX, në instancën Gjirokastrë, me datë fillimi 15.02.2016 dhe datë mbarimi 01.01.2020. Nga data 04.02.2020 kjo kontratë mr Nr. XXXXXXXXXXXX, i përketë titullarit/përdorues z. X. X.***

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim me nr. 739 prot, datë 31.08.2021 nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA Rajoni Gjirokastrë sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “*OL VAHROM*” SHPK nuk rezulton debitor, deri në datën 31.08.2020, përfshirë edhe vlerën e faturës koherente të muajit Korrik 2020, për kontratën me kod XXXXXXXX



përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 21.09.2020 dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”. Referuar Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar rezulton se subjekti “*OL VAHROM*” SHPK ndër të tjera ushtron aktivitet edhe në adresën Rruga “*Selaudin Zorba*” ish serat, vëretuar kjo edhe nga korespondenca me OSHEE Group SHA ku citon se: “*Me gjeneralitetet subjekti “OL VAHROM” SHPK, referuar të dhënave sistemit të faturimit identifikohet 1 (një) abonent titullar me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXXX, në instancën Tiranë, në adresën A.S.Zorba*”. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA., si dhe verifikimeve të kryera në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të operatorit ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK, rezulton se shoqëria disponon dy kontrata të energjisë elektrike me adresa një në Gjirokastrë dhe një në Tiranë Rruga “*Selaudin Zorba*”. Referuar sistemit prokurimeve elektronike rezulton se subjekti “*OL VAHROM*” ka paraqitur vërtetim debie vetëm për njërin nga adresat e ushtrimit të aktivitetit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA Rajoni Gjirokastrë, ndërkohë për adresën Tiranë Rruga “*Selaudin Zorba*”, nga verifikimet në SPE nuk rezulton të ketë dorzuar vërtetim debie për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike. Në rastin konkret operatori ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK për adresën Tiranë Rruga “*Selaudin Zorba*” nuk ka arritur të provojë së ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike, gjithashtu edhe vërtetimi i ngarkuar në SPE me nr. 739 prot, datë 31.08.2020, nuk asnjë informacion në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për *abonentin titullar me kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXXX, në instancën Tiranë, në adresën A.S.Zorba*. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për *kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXXXXXXX, në instancën Tiranë, në adresën A.S.Zorba*, duke mos përmbushur në këtë mënyre kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*OL VAHROM*” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “*OL VAHROM*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.9., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*OL VAHROM*” mbi shoqëritë “*I.D.K Konstruktion*” SHPK, “*Vila Dekor*” SHPK “*Deutschcolor*” SHA Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 19.10.2020, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur

nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këto operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK mbi shoqërinë “*I.D.K Konstruksion*” SHPK, “*Vila Dekor*” SHPK “*Deutschcolor*” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK mbi operatorin tjetër të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” (i ndryshuar), me titull “*Të drejtat e personit të interesuar*” parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*OL VAHROM*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 67976-08-06-2020, me objekt “*Blerje materiale bojaxhiu*”, me fond limit 66.666.580 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës së mësipërme të prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1466 Protokoli, Datë 10.11.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**